

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE SHKUP

Drejtuar:

Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

RAPORT VJETOR PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP, PËR VITIN 2018

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative Shkup ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 71 nga 19.04.2018), drejtori i Agjencisë Teknike Operative Shkup (në tekstin e mëtejme – ATO) e dorëzoi Raportin për Punën e ATO-së për vitin 2018:

I. Gjatë vitit 2018, ATO-ja teknikisht ndërmjetësoi në aktivizimin e masës ndjekja e komunikimeve në gjithsej 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) komunikime për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë.

Nga 153 komunikimet e theksuara:

- 5 (pesë) komunikime teknikisht u ndoqën nga ATO-ja për nevojat e SPKOS-së (Seksioni për Parandalimin e Krimit të Organizuar dhe Serioz) në BSP pranë MPB-së; dhe

- 8 (tetë) komunikime teknikisht u ndoqën nga ATO-ja për nevojat e PSP-së (Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të Ndërlidhura dhe që Rezultojnë nga Përmbajtja e Ndjekjes së Paligjshme të Komunikimeve).

II. Në pajtim me nenin 32 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative Shkup, gjatë vitit 2018 (nëntor) me vendim të drejtorit të ATO-së ishte formuar Komisioni për Mbikëqyrjen Profesionale të Operatorëve në përbërje të 3 (tre) anëtarëve (në tekstin e mëtejme – Komisioni). Në vitin 2018, Komisioni realizoi disa takime pune me përfaqësuesit e operatorëve në Republikën e Maqedonisë dhe në to ishte prezantuar Propozim-udhëzimi për mënyrën e veprimit të operatorëve dhe ai ishte publikuar në faqen e internetit të ATO-së. Duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor të funksionimit të ATO-së në vitin 2018 (nëntor dhe dhjetor), Komisioni objektivisht nuk kishte hapësirë kohore të realizojë mbikëqyrje zyrtare në punën e operatorëve.

III. Gjatë vitit 2018 në ATO nuk ishte zbatuar asnjë procedurë disiplinore kundër punonjësit në ATO.

IV. Gjatë vitit 2018 nga gjithsej buxheti i parashikuar 3.260.000,00 (tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) denarë, në pajtim me Planin Financiar të ATO-së për vitin 2018, u shpenzuan gjithsej 968.021,00 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëzet e një) denarë, si në vijim:

475.601,00 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e një) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të rrogave dhe kontributeve për sigurimin social të punonjësve në ATO për vitin 2018, dhe

492.420,00 (katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të harxhimeve të tjera për zërat si në vijim:

- 35.536,00 (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të harxhimeve të rrugës dhe ditore (një udhëzim zyrtar katërditor jashtë vendit);

- 84.262,00 (tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të shërbimeve komunale, ngrohje, komunikime dhe transport;

- 3.788,00 (tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të harxhimeve materiale dhe inventarit të imët;

- 71.329,00 (shtatëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e nëntë) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të riparimeve dhe mirëmbajtjes rrjedhëse;

- 247.720,00 (dyqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të shërbimeve kontraktuese;

- 49.785,00 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) denarë mjete financiare janë shpenzuar në bazë të harxhimeve të tjera rrjedhëse.

Me respekt,

DREJTOR

Zoran Angellovski
